

RREGULLORJA E INVESTIGIMIT DHE DISIPLINES

Përmbajtja e Rregullores:

TE PERGJITHSHME	2
<i>Neni 1: Qëllimi</i>	<i>2</i>
<i>Neni 2: Objekti i Rregullores</i>	<i>2</i>
<i>Neni 3: Përkufizime</i>	<i>2</i>
ORGANIZIMI DHE DREJTIMI	3
<i>Neni 4: Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës - KID.....</i>	<i>3</i>
<i>Neni 5: Objekti i Veprimtarisë së KID.....</i>	<i>4</i>
<i>Neni 6: Funksionimi i KID</i>	<i>5</i>
<i>Neni 7: Raportimi.....</i>	<i>6</i>
<i>Neni 8: Pavarësia e Anëtarëve të KID.....</i>	<i>6</i>
NISJA E PROCEDIMEVE DHE PROCESI INVESTIGIMIT	6
<i>Neni 9: Ankesa, depozitimi dhe forma e saj.....</i>	<i>6</i>
<i>Neni 10: Investigimi mbi bazë ankese</i>	<i>7</i>
<i>Neni 11: Investigimi mbi bazën e informacioneve të tjera - jo ankese</i>	<i>7</i>
<i>Neni 12: Kryerja e investigimit dhe dokumentimi tij.....</i>	<i>7</i>
<i>Neni 13: E drejta e përfaqësimit</i>	<i>8</i>
SHQYRTIMI I PROCESIVE INVESTIGATIVE DHE MASAT DISIPLINORE	9
<i>Neni 14: Shqyrtimi nga Këshilli Drejtues dhe masat disiplinore</i>	<i>9</i>
APELIMI	9
<i>Neni 15: Procedura e Apelimit</i>	<i>9</i>
ADMINISTRIMI I PROCESIT INVEGIGATIV	9
<i>Neni 16: Mbajtja e Regjistrimeve dhe e evidencës.....</i>	<i>9</i>
<i>Neni 17: Informimi dhe Publikimi për anëtarët e IEKAs.....</i>	<i>10</i>

RREGULLORJA
E
INVESTIGIMIT DHE DISIPLINËS

Në zbatim të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, neni 5, neni 12, neni 14, neni 55 dhe 57, dhe në zbatim të kërkesave të deklaratës së detyrimeve të anëtarësisë SMO – Nr. 6 të publikuar nga Bordi i IFAC-ut, me propozim të Këshillit Drejtues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar(IEKA), Bordi i Mbikëqyrjes Publike, vendosi të miratojë këtë rregullore për të përcaktuar Rregullat dhe procedurat e Investigimit dhe disiplinës për anëtarët e IEKA-s :

TE PERGJITHSHME

Neni 1: Qëllimi

1. Rregullorja e Investigimit dhe Disiplinës ka si qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për vendosjen e një regjimi investigativ dhe disiplinor të drejtë dhe efektiv ndaj sjelljeve të anëtarëve të IEKA-s që bien në kundërshtim me:
 - dispozitat e ligjit “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”,
 - të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij,
 - të akteve statutore të organizatës, dhe me
 - standartet e rregullat profesionale
2. Të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e palëve në këtë proces.
3. Të përcaktojë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës (KID).

Neni 2: Objekti i Rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje janë:

1. Investigimi i sjelljeve të këqia të shoqërive të auditimit dhe ekspertëve kontabël të regjistruar (EKR) mbi bazën informacioneve të besueshme ose programeve tematike, të autorizuara nga Këshilli Drejtues.
2. Verifikimi i ankesave të paraqitura pranë IEKA-s dhe në BMP nga persona apo subjekte të tjera.
3. Dhënia e udhëzimeve për anëtarët e IEKA-s, lidhur me zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

Neni 3: Përkufizime

1. Termat e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në ligjin “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.
2. Përveç tyre, termat e tjera vijuese kanë këto kuptime:
 - (a) **Anëtar** - një individ, një praktikant i vetëm (person fizik), partneritet apo shoqëri e profesionistëve kontabël, që është anëtar, ose ndryshe subjekt i autoritetit të IEKA-s. (ekspert kontabël i autorizuar, stazhier, shoqëri vendase dhe të huaja).

- (b) **Ankesë** - Pretendimet e ngritura për ekzistencën e një sjellje të keqe, nga një palë e tretë ndaj anëtarëve të IEKA-s, e paraqitur në formë të shkruar, dhe që përmbajnë elementët e domosdoshëm të përcaktuar nga kjo rregullore, mbi të cilat të mund të gjykohet për kryerjen e një verifikimi.
- (c) **BMP** – Bordi i Mbikqyrjes Publike
- (d) **Firmë anëtare** – një person fizik, ortakëri ose shoqëri tregtare e profesionistëve të auditimit që është anëtare e IEKAs.
- (e) **IEKA** – Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
- (f) **Investigim bazuar në ankesë** – Fillimi i një investigimi duke u bazuar në një ankesë. Ky lloj investigimi iniciohet sapo Instituti merr një ankesë kundrejt një anëtari të tij qoftë ky person fizik apo firmë. Zakonisht, këto ankesa vijnë nga një klient ose nga një agjenci tjetër rregullatore.
- (g) **Investigim bazuar në informacione nga burime të sigurta (të tjera)** - Fillimi i investigimit mbi bazën e informacionit të marrë nga burime të sigurta, që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe, madje edhe po qe se nuk ka ankesë.
- (h) **KD** – Këshilli Drejtues të IEKA-s
- (i) **KID** - Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës.
- (j) **Përpyjekjet më të mira** – Një organizëm anëtare (IEKA) ka bërë përpjekjet më të mira, në se në mënyrë të arsyeshme ai nuk mund të bënte më shumë për të përmbushur një detyrim të caktuar të anëtarësisë;
- (k) **Sjelljet e këqia** - përfshijnë të gjitha si dhe çdonjërin nga veprimet e mëposhtme:
- . Aktivitetin kriminal;
 - . Veprimet ose mos-veprimet që ka të ngjarë të çojnë në diskreditimin e profesionit;
 - . Shkeljet e standardeve profesionale;
 - . Shkeljet e kërkesave etike;
 - . Neglizhencën e madhe profesionale;
 - . Një numër rastesh të neglizhencës profesionale, edhe pse më pak serioze, por që në mënyrë kumulative mund të tregojnë për papërshtatshmërinë e të drejtave të ushtrimit të profesionit;
 - . Punën e pakënaqëshme ose jo-bindëse
- (l) **Verifikimi mbi bazë ankese** - është procesi i njohjes dhe konfirmimit të vërtetësisë së pretendimeve apo shqetësimeve për fakte dhe rrethana që lidhen me veprimtarinë e EKR-ve konkrete dhe që realizohet nëpërmjet marrjes, grumbullimit, analizës e ballafaqimit të të dhënave konkrete

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI

Neni 4: Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës - KID

1. Me qëllim të zbatimit të rregullave dhe procedurave të vendosura nga kjo rregullore dhe të akteve të tjera rregullative për regjimin investigativ dhe disiplinor si dhe për të respektuar të drejtat e palëve gjatë këtij procesi krijohet Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës (KID).

2. Komiteti i Investigimit dhe i Disiplinës është komitet në varësi të drejtpërdrejtë të Këshillit Drejtues të IEKA-s.
3. KID ka në përbërje të tij katër anëtarë. Kryetari dhe Anëtarët e KID zgjidhen nga Këshilli Drejtues në fillim të çdo mandati të tij.
 - Kryetar, i KID-it caktohet anetari i Këshillit Drejtues që mbulon çështjet e investigimit dhe disiplinës;
 - Këshilli Drejtues miraton si anëtarë të KID, dy ekspertë kontabël të regjistruar anëtarë të IEKAs; dhe një individ tjetër jashtë anëtarësisë, me profesionin Jurist.
 - Përfundimisht për mandatin e parë, dy anëtarë të KID, të zgjedhur nga rradhët anëtarësisë të IEKA-s, emërohen për një mandat 2-vjeçar.
4. Anëtarët e komitetit emërohen nga Këshilli Drejtues, duke u përzgjedhur ndërmjet EKR-ve që përmbushin kriteret për t'u zgjedhur si anëtar të Këshillit Drejtues. Qënia anëtar në KID është e papajtueshme me funksionet në Komitetet apo Komisionet e tjera të IEKA-s.
5. Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të KID realizohet si vijon:
 - (a) Për anëtarët të cilët janë nga rradhët e anëtarësisë:
 - i. KD i IEKA-s, shpall në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas të cilit fton anëtarët e saj të shprehin interesin për tu përzgjedhur si anëtarë të KID.
 - ii. Afati për paraqitjen e kandidaturave është 21 ditë kalendarike nga data e shpalljes së njoftimit.
 - iii. KD i IEKA-s, përzgjedh me votim të thjeshtë dy prej kandidaturave të paraqitura.
 - (b) Për anëtarin jurist jashtë rradhëve të anëtarësisë, KD i IEKA-s, fton një jurist i cili ka njohuri dhe kompetencë profesionale të nevojshme mbi profesionin e EKR.
6. Funkzioni i anëtarit të KID përfundon kur:
 - I ka mbaruar mandati;
 - Kur ndaj anëtarit është marrë masa disiplinore me pezullim për një periudhë kohe të caktuar;
 - Kur gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit bie në kushte të papajtueshmerive me kërkesat statutore apo të rregullores.
7. Anëtarët e KID mund të shkarkohen me vendim të KD në ato raste kur veprimet apo mosveprimet e tyre, bien ndesh me statutin, ligjin apo shkelje të rënda dhe të përsëritura të kësaj rregullore.

Neni 5: Objekti i Veprimitarisë së KID

1. Investigimi i sjelljeve të këqia të ekspertëve kontabël të regjistruar (EKR), të shoqërive të auditimit dhe/ose të stazhierëve kandidatë për ekspertë kontabël të regjistruar, të cilat inicohen bazuar në informacione të besueshme të raportuara në IEKA ose përfshihen në programe që autorizohen nga Këshilli Drejtues.
2. Shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga persona apo subjekte të tjera në IEKA dhe në BMP për EKR-të, shoqërite e auditimit dhe stazhierët.
3. Investigimi bazuar në autorizimin e KD të IEKAs, i rasteve të mosplotësimit të kushteve ligjore, rregullatore dhe të papajtueshmërisë të EKR-ve, shoqërive të auditimit dhe të stazhierëve.

4. Investigimi bazuar në autorizimin e KD të IEKAs, i rasteve të mosdeklarimit të misioneve në pajtim me kërkesat statutorë e ligjore.
5. Investigimi në raste të vecanta i rrethanave kur nga misionet e deklaruara për KKD, vërehen mospërputhje dhe anomali, me autorizim të KKD.
6. Investigimi i mëtejshëm i rasteve kur rezultatet e kontrollit të cilësisë janë dobët ose shumë dobët me autorizim të KD-së.
7. Investigimi i atyre rrethanave që nga KD gjykohen se dëmtohet reputacioni i profesionit dhe i organizmit profesional.
8. Raportimi i rezultateve të procedurave dhe konkluzioneve të arritura për cdo rast në KD të IEKA-s.
9. Përfaqësimi në BMP të rasteve të përcjella nga KD i IEKA-s në BMP.

Neni 6: Funksionimi i KID

1. Kryetari KID-it organizon dhe ndjek realizimin e proceseve investigative.
2. Mbledhjet e KID kryesohen nga Kryetari ose në mungesë të tij nga njëri prej anëtarëve të KID, ekspert kontabël i regjistruar.
3. KID mund të marrë vendime të vlefshme kur në mbledhje janë të pranishëm jo më pak se tre anëtarë. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast votash të barabarta ajo e Kryetarit është përcaktuese.
4. Në përfundim të procesit të investigimit, KID duhet të rishikojë evidencën e grumbulluar dhe të marrë vendime për rastin e shqyrtuar prej tij. Dosja me konkluzionet e arritura dhe masat e propozuara i dërgohen Këshillit Drejtues të IEKA-s.
5. Vendimet e KID pasqyrohen në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari ose, në qoftë se ai ka pengesa apo është në pamundësi të ushtrojë funksionet e tij, nga personi i cili është ngarkuar për mbajtjen e procesverbalit.
6. Procesverbalet e mbledhjeve të KID dhe i gjithë dokumentacioni që shoqëron praktikën investiguese ruhen në selinë e Institutit në një ambient që siguron konfidencialitetin dhe ruajtjen e informacionit.
7. Vendimet reflektojnë rezultatin e votimit dhe firmosen nga të gjithë anëtarët e KID.
8. KID mundet të krijojë grupe pune teknike që ai gjykon të dobishme për të përmbushur objektin e investigimit. Në këto raste, KID i kërkon KD-së të IEKA-s të ftojë persona anëtarë të Institutit ose profesionistë të fushave të tjera specifike, për të marrë pjesë në këto grupe pune, të cilët angazhohen në proceset investigative.
9. KID me autorizimin e KD të IEKA-s përfaqëson Institutin pranë BMP-se dhe autoriteteve të tjera në rast se është e nevojshme.
10. Anëtarët e KID dhe të angazhuarit në proceset investigative kanë të drejtën e shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve në masën e përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 7: Raportimi

1. KID harton një raport të veprimtarisë vjetore, i cili i dërgohet për miratim në Këshillin e Drejtimit.
2. Raporti i KID i miratuar nga Këshilli Drejtues i paraqitet për shqyrtim Bordit të Mbikqyrjes Publike, brenda dates 15 Mars të vitit pasardhës.
3. Raporti i KID duhet të përmbajë të paktën këto elemente:
 - a. Një përshkrim mbi aktivitetin e kryer dhe proceset investigative që janë kryer gjatë periudhës raportuese.
 - b. shkeljet e ligjit, të akteve në zbatim të tij, të akteve statutoare apo të rregullave dhe të standardeve të profesionit që janë konstatuar gjatë proceseve investigative;
 - c. dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara;
 - d. Propozimet dhe rekomandimet për veprimet që priten të ndërmerren në të ardhmen.

Neni 8: Pavarësia e Anëtarëve të KID

1. KID duhet të konfirmojë që në fillim të çdo procesi investigativ, se çdo anëtar i caktuar për të kryer apo ndihmuar një investigim, është i pavarur nga çështja që investigohet, dhe nuk është i lidhur apo ka interesa në çështjen që investigohet. Nëse ka konflikt që në fillim ose nëse konflikti lind gjatë investigimit, anëtari duhet të largohet menjëherë nga investigimi i çështjes.
2. Në rast se zbulohen fakte apo rrethana që vërtetojnë konfliktin e interesit të anëtarit apo të çdo personi tjetër të përfshirë në procesin e investigimit, por që nuk janë vetë deklaruar, atëhere Kryetari i KID merr masa për eliminimin e kushteve të papajtueshmërisë dhe informon KKD për këtë situatë.

NISJA E PROCEDIMEVE DHE PROCESI INVESTIGIMIT

Neni 9: Ankesa, depozitimi dhe forma e saj

1. Ankesat e ardhura në IEKA drejtpërdrejt apo nëpërmjet BMP-së, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajnë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana të ekzistencës së një sjellje të keqe, mbi të cilën mund të gjykohet për kryerjen e nje procesi investigimi.
2. Ankesa duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:
 - a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë,
 - b. Të dhëna mbi EKR-në ose shoqërinë e auditimit objekt i ankesës
 - c. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe kohën e ndodhjes së tyre,
 - d. Dokumentet apo burimet mbështetëse të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara.
3. Gjatë procesit investigativ ankimuesi mund të plotësojë dokumentacionin mbështetës me dokumenta të tjera që ai i gjykon të arsyeshme, si edhe me dokumentacione të tjera që mund ti kërkojnë nga KID në funksion të procesit të investigimit.

Neni 10: Investigimi mbi bazë ankese

1. Ankesat ndaj EKR-ve, ose shoqërive të auditimit, apo ortakëve të angazhimit, regjistrohen në sekretarinë e Institutit.
2. Ankesat e depozituara në IEKA, brenda 3 ditëve pune i përcillen zyrtarisht për shqyrtim kryetarit të KID dhe njëkohësisht informohet Kryetari i Këshillit Drejtues.
3. Kryetari KID, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit për ankesën, thërret mbledhjen e KID për shqyrtimin e saj .
4. KID në mbledhjet e organizuara për shqyrtimin e ankesave merr vendim lidhur me:
 - Autorizimin e fillimit të investigimit;
 - Caktimin e anëtarit apo grupit të punës që do të kryejnë investigimin;
 - lëndën objekt verifikimi;
 - detyrat e verifikimit;
 - dokumentacionin shtesë që mund të kërkohet për kryerjen e investigimit;
 - afatin e kryerjes së verifikimit.
5. Përfundimi i verifikimit të ankesës nga KID-i , bëhet jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e fillimit të procesit të investigimit. Ky afat mund të shtyhet nga Kryetari i KD-së mbi bazën e kërkesës së Kryetarit të KID dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe të argumentuara.
6. KID njofton me shkrim, nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv të IEKAs, palët e përfshira në proces dhe ato të interesuara kur ai nis një proces investigativ.

Neni 11: Investigimi mbi bazën e informacioneve të tjera - jo ankese

1. Në rastet kur KD i IEKA-s, disponon informacione të marra nga burime të sigurta, që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe të anëtarit apo anëtarëve të saj, ai autorizon KID për fillimin e një procesi investigimi.
2. Investigimi mbi bazën e informacioneve – jo ankese mund të kryhet si për veprimtarinë e drejtpërdrejtë profesionale ashtu dhe për çështjet që lidhen me zbatimin e detyrimeve të tjera si anëtar i IEKA-s.
3. Për investigimet mbi bazën e informacioneve – jo ankese koha dhe afatet duhet të përcaktohen në autorizimin e investigimit. Ky afat mund të shtyhet nga KD-ja bazuar në kërkesën e Kryetarit të KID vetëm për shkaqe të arsyeshme e të argumentuara.

Neni 12: Kryerja e investigimit dhe dokumentimi i tij

1. KID ka përgjegjësinë e trajtimit të sigurtë dhe konfidencial të dokumentave dhe evidencës që merr nga palët, e vecanërisht për mbrojtjen e interesave të ankuesit dhe të anëtarit subjekt ankimimi.
2. KID gjatë kryerjes së procesit investigativ duhet të testojë nëse sjellja e anëtarit (apo e firmës anëtare) ka dështuar të jetë e njëjtë me atë që do të kishte qënë parashikuar të ishte për rrethanat, në të cilën ka ndodhur apo rrjedhur ngjarjet.

3. Për të përmbushur misionin e tij, KID nëpërmjet Kryetarit të KD, ka të drejtë t'u kërkojë anëtarëve, firmave anëtare dhe palëve të treta informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionet e duhura për çështjen që investigohet.
4. Anëtarët IEKA-s, duhet të koepërojnë në proceset e investigimit, dhe t'u përgjigjen në kohë të arsyeshme të gjitha komunikimeve të bëra nga Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës. Anëtarët të cilët nuk bashkëpunojnë apo nuk i përgjigjen në kohë komunikimeve të KID, i nënshtrohen sanksioneve të parashikuara për rastet e shkeljeve etike (sjellje profesionale).
5. Në përfundim të procesit të investigimit KID rishikon të gjithë evidencën dhe faktet e grumbulluara dhe mblidhet për të marrë vendim, i cili duhet të përmbajë dhe mendimin e komitetit për faktin nëse ka fakte apo rrethana që mund të cojnë në iniciimin e një procesi disiplinor ndaj anëtarit/ëve të përfshirë.
6. Vendimi i KID duhet të shoqërohet me një relacion përshkrues, i cili duhet të përmbajë:
 - objektin e verifikimit;
 - pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit;
 - pretendimet apo arsyetimet e mundshme të EKR-së apo shoqërisë së auditimit;
 - referencë të dokumentave, faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkelje në referim të ligjit dhe standarteve profesionale;
 - përmbledhjen e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;
 - përfundimet nëse ekzistojë në rastin konkret shkelje të ligjit, të standardeve teknike, profesionale dhe të kërkesave etike si dhe vlerësimin nëse ato përbëjnë ose jo shkaqe të arsyeshme për marrjen e masave disiplinore;
 - propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të verifikimit.

Neni 13: E drejta e përfaqësimit

1. Në kryerjen e investigimit KID udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së anëtarit të përfshirë në çështjen që investigohet, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij dhe të trajtimit të tij në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë. Në procesin e investigimit anëtari subjekt ankimimi mund të asistohet nga një këshilltar ose nga një avokat.
2. Kur e gjykon të nevojshme KID organizon seanca dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.
3. Përpara marrjes së vendimit KID organizon të paktën një seancë dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.
4. Njoftimi për organizimin e seancës dëgjimore dërgohet me shkrim të paktën 5 ditë përpara organizimit të saj.
5. Palët e përfshira në procesin investigativ kanë të drejtë që gjatë seancave dëgjimore të asistohen dhe/ose të përfaqësohen nga një këshilltar ose nga një avokat. Në rastet e delegimit të të drejtës së përfaqësimit tek persona të tretë, ata duhet të paraqesin një autorizim me shkrim për të drejtën e përfaqësimit.

Neni 14: Shqyrtimi nga Këshilli Drejtues dhe masat disiplinore

1. Në përfundim të një procedure investigimi KID-i, harton një relacion shpjegues, dhe përcakton propozimin për vendimin që duhet marrë.
2. Relacioni së bashku me propozimin për masën që duhet marrë i dërgohen për shqyrtim Këshillit Drejtues të IEKA-s.
3. Kur relacioni që shoqëron propozim e KID-it nuk është i plotë dhe mjaftueshmërisht i argumentuar, KD e kthen çështjen për rishqyrtim pranë KID dhe përcakton edhe afatet e këtij rishqyrtimi.
4. Për të gjitha rastet e investiguara, për të cilat Këshilli Drejtues ka vendosur të ngarkojë me përgjegjësi profesionale anëtarin e IEKA-s, dosja e investigimit që përmban rezultatet e verifikimeve dhe relacionin e KID-it, së bashku me vendimin e Këshillit në të cilin është kategorizuar shkelja, i kalojnë për gjykim BMP-së për masa disiplinore.
5. Për rastet e investiguara mbi bazë ankese, për të cilat Këshilli Drejtues ka vendosur të mos ngarkojë me përgjegjësi profesionale, vendimi i i KD-së, së bashku me realcionin shpjegues të KID-it, i përcillen si informacion BMP-së.

APELIMI

Neni 15: Procedura e Apelit

1. KID përfqëson IEKA-n në mbledhjet e BMP-së kur shqyrtohen rastet e propozuara prej IEKAs për marrje masash disiplinore.
2. KID, me miratim të KD të IEKA-s, mund të apelojë vendimin e BMP-së në ato raste kur ai gjykon se sanksioni i vendosur nga BMP-ja është mjaft i butë, në raport me vlerësimin e tij.

ADMINISTRIMI I PROCESIT INVESTIGATIV

Neni 16: Mbajtja e Regjistrimeve dhe e evidencës

1. Për çdo çështje (praktikë) investigimi hapet një dosje sipas një modeli të caktuar nga KID-i, me një referencë lidhëse të përshtatshme, e cila administrohet në IEKA. Kjo dosje përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit investigues që nga fillimi i tij deri në përfundimin e procesit.
2. Në çdo mbledhje të Komitetit mbahet një procesverbal, ku pasqyrohen data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejtuesi i saj, çështjet që janë diskutuar, forma dhe rezultatet e votimeve. Në fund të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.
3. Drejtori ekzekutiv është përgjegjës për marrjen në kohë të të gjitha masave për asistimin e KID në çështjet administrative, sekretariale dhe logjistike.

Neni 17: Informimi dhe Publikimi për anëtarët e IEKAs

1. Vendimet e marra nga bordi publikohen me autorizimin e tij.
2. Me vendim të Këshillit Drejtues mund të publikohen raportet e çeshtjeve të investiguara, pa përmendur emrat e palëve të përfshira, për rastet që ndihmojnë në zbatimin praktik të standardeve, rregullave dhe kodit të etikës, dhe identifikojnë kurthet që duhen shmangur.
3. KID mund të propozojë përfshirjen në programin e kualifikimit të vazhdueshëm të anëtarëve çështjet apo rastet e investigura me qëllim që të informojë dhe ndërgjegjësojë të gjithë anëtarët e IEKA-s në lidhje me:
 - a) Zbatimin e dispozitat e Kodit të Etikës dhe të rregullave e standardeve profesionale të zbatueshme, si edhe të kërkesave që burojnë nga detyrimet e anëtarësisë në IFAC, dhe
 - b) Pasojat e mospajtueshmërisë me këto kërkesa.

Miratuar me Vendimin Nr. 16, datë 30.05.2011 dhe ndryshuar me Vendimin nr. 9 datë 16.07.2013 të Bordit të Mbikqyrjes Publike.